



KEPUBLIKA I KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA RAHOVEC / ORAHOVAC MUNICIPALITY RAHOVEC / MUNICIPIO DE ORAHOVAC



Njësie Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës)



Nr./Br./No 106 Nr. ifaq/Br.str./No.pr. 105

Data/Datum/Date 1 / 2 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL
JANAR 2023



PËRMBAJTJA

HYRJE	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE TË DREJTORËVE TË DREJTORIVE	3
PËRFUNDIM	11

HYRI

Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtoreve gjatë muajve të vitit 2023.

Rrëndësia e botimit të buletinit muor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe të rezultatet e të aktiviteteve të Komunës së Rahovecit, në mënyrë të tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji janar i vitit 2023, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh të kryetarit dhe të drejtorëve të drejtoreve.

Me anë të këtij buletini muor për muajin janar, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtoreve në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËV TË DREJTORIVE



Bashkë me z. Valentin Hoxha, përfaqësues nga Fondacioni pér Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik- PREDA Plus Kosovë dhe Wentreprenuer, nënshkruam memorandum bashkëpunimi pér zbatimin e projektit "INTEGRA-Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të të rinjve të kthyer dhe të njerëzve të cenueshëm lokalë në Kosovë". Ky memorandum ka pér qëllim ndërtimin e aftësive të 120 personave të kthyer dhe personave nga grupet në rrezik në planifikimin dhe menaxhimin e biznesit dhe sigurimin e të mirave materiale/kapitale pér 100 biznese të reja, forcimin e kapaciteteve dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet 35 përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe qendror, sigurimi i kompetencave dhe rikuvalifikimi i 50 përfituesve të përzgjedhur përmes Trajnimit të Arsimit Profesional, ofrimin e mundësive të punësimit të lehtësuar në kompanitë ekzistuese, pér 60 përfitues, krijimin e 5 Qendrave të Angazhimit të Komunitetit (QAK).

Bashkë me z. Agron Beka, drejtor ekzekutiv i organizatës joqeveritare "Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë", kryetari Latifi ka nënshkruar Memorandum pér Mirëkuptim dhe Bashkëpunim, me qëllim të ofrimit të shërbimeve juridike falas pér qytetarët e komunës tonë. Komuna e Rahovecit do ta ofrojë hapësirën dhe logistikën e nevojshme pér realizimin e qëllimeve të marrëveshjes dhe pér efikasitetin e mbarëvajtjes së saj.





Kryetari Latifi, në zyrën e tij, ka pritur një delegacion (Toger Edin Oruçi, ushtar specialist, Arbenit Tahiri dhe ushtar specialist Granit Nikqi) që përfaqësonin FSK-në, Ushtrinë e Republikës se Kosovës, i cili para nesh paraqiti mundësinë që ofron FSK-ja për rekrutimin e ushtarëve të rinj nga komuna e Rahovecit. Me këtë rast kryetari ftoi të gjithë të rinjtë nga mosha 18 e deri në moshën 25 vjeçare, që të aplikojnë në konkursin për pranimin e ushtarëve të rinj në FSK.

Bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Përparim Krasniqi dhe shefin e kabinetit, z. Ali Morina, kryetari Latifi priti në takim z. Luan Hasanaj, nga organizata "Let's Do It"- ta pastrojmë Kosovën dhe rrjetin e ambientalistëve "We Are One", ku paraqiten planet e tyre në fushën e mjedisit dhe mundësitë e bashkëpunimit me ne në këtë fushë. Padyshim, jemi çdo herë të hapur për zgjerimin dhe për thellimin e bashkëpunimit, me qëllim të rritjes së fondit të investimeve konkrete, të masave për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit, sepse mjedisi është prioritet i lartë i udhëheqjes në komunën tonë.



Me rastin e ikjes në amshim të Prof. Dr. Sabahajdin Cena, Komuna e Rahovecit organizoi mbledhjen komemorative, si dhe kryetari mori vendimin për themelimin e Këshillit Organizues për mbarëvajtjen e varrimit. të Prof. Dr. Sabahajdin Cena i cili u bë një me luftën çlirimtare duke u bërë kronisti i kësaj historie të lavdishme në trojet shqiptare e më gjerë. Emri i tij do të gdhendet me shkronja ari, ndërsa kronikat e tij për UÇK-në do të vazhdojnë të bëjnë jehonë në histori. Lavdi e nderim për njeriun e pushkës e të penës, profesor Dr. Sabahajdin Cena!





15 JANARI, DITA E GJENOCIDIT SERB NË KOSOVË
Në kujtim të kësaj dite, kryetari së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ndezën qirinj në vendet ku barbarët serbë kanë bërë masakra në komunën tonë, si: Rahovec, Krushë e Madhe, Celinë, Fortesë, Apterushë, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Pastasel, Dejnë, Polluzë. Për të gjitha këto krime të tmerrshme dhe gjenocidin e Serbisë ndaj burrave, grave, fëmijëve të Kosovës që kërkonin liri, fatkeqësisht drejtësia ende nuk ka vepruar, nuk e ka thënë fjalën e vet.

Kryetari Latifi, së bashku me Kryetarin Ramush Haradinaj dhe bashkëpunëtorët, ishin për ngushëllime në familjen e nderuar Cena, për të ndarë sadopak dhimbjen dhe krenarinë me familjen dhe me miqtë, pas ndarjes ngajeta të profesorit të respektuar, luftëtarit të ditëve të para, njeriut të shkencës e të kulturës tonë kombëtare, Prof. Dr. Sabahajdin Cena. Me këtë rast, Kryetari Haradinaj ndau edhe medaljen "ME BESIM NË ZOT, ATDHE E SHTET", për kontributin e Prof. Dr. Sabahajdin Cena në çështjen shqiptare.



Institucionet më kredibile, si vendore e ato ndërkombëtare, tanimë e vlerësojnë punën e mirë të kryetarit Smajl Latifi, në transparencë dhe në efikasitet në qeverisje. Kjo performancë e mirë në qeverisje nuk është rastësi, pasi Rahoveci shquhet për traditën dhe njerëzit e saj të devotshëm ndaj punës. Kryetari Ramush Haradinaj ka takuar kryetarin Latifi dhe ekipin e tij të suksesshëm, të cilët po na bëjnë krenarë me sukseset e arritura, duke dhënë shembullin e një qeverisjeje të mirë në dobi të qytetarit.

Komuna e Rahovecit e para për transparencë komunale edhe për gjysmën e dytë të vitit 2022

Kryetari Latifi ka informuar bashkëqytetarët se komuna jonë përsëri është shpallur kampione për transparencë, duke u renditur në vendin e parë në mesin e 38 komunave të Kosovës!

Vlerësimi është bërë në kuadër të studimit “Transparometri Komunal”, i zbatuar nga konzerciumi i OJQ-ve “Aleanca Qytetare për Transparencë”, i përbërë nga Institut i Demokratik i Kosovës, ku pasqyrohen të gjeturat e nivelit të transparencës së institucioneve lokale për 38 komunat e Kosovës për gjysmën e dytë të vitit 2022 (korrik– dhjetor). Një nga zotimet tona kryesore ishte pikërisht transparenca dhe llogaridhënia para qytetarëve.

Vlerësimi i transparencës së komunave Kosova – Dhjetor 2022

Ranking	Renkënie	Përfshi	Përqindje
1	Rahovec	99	100%
2	Liplan	99	100%
3	Prizren	99	100%
4	Gjilan	97	98.75%
5	Gjakova	97	98.75%
6	Kamenicë	97	98.75%
7	Mogila	97	98.75%
8	Prezë	97	98.75%
9	Deçan	96	98.25%
10	Peć	94	97.50%
11	Hani i Hotit	93	97.25%
12	Skopelje	79	63.25%
13	Malishevë	79	63.25%
14	Sukobica	71	56.25%
15	Ferizaj	67	54.38%
16	Kosovës	66	53.75%
17	Reka	66	53.75%
18	Shkodra	66	53.75%
19	Vushtrri	66	53.75%
20	Lezhë	79	63.25%
21	Gjilan	76	63.25%
22	Viti	74	62.50%
23	Ajtos	73	62.50%
24	Glloshi	73	62.50%
25	Qorçë	70	58.75%
26	Dragash	60	50.00%
27	Gostivar	75	63.75%
28	Markusha	63	53.13%
29	Shtamë	56	48.75%
30	Flushë-Kosovë	98	100.00%
31	Prilep-Vardar	69	53.75%
32	Leposaviç	66	53.75%
33	Ritobet	65	54.38%
34	Rrëshen	64	54.38%
35	Zveçan	63	53.75%
36	Prilep-Borda	37	30.00%
37	Partizan	36	30.00%
38	Zelina-Pec	33	26.25%



Kryetari Latifi, bashkë me nënkyretarin Iska dhe me bashkëpunëtorë, priten në takim Përfaqësuesit nga Agjencia e Statistikave e Kosovës. Përfaqësuesit e ASK-së i njofuan udhëheqësit komunal se gjatë këtij viti ASK-ja planifikon ta bejë regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. Periudha e cila do të realizohet regjistrimi i popullsisë është data 1 shtator deri më 16 tetor 2023. Regjistrimi do të jetë gjithëpërfshirës dhe të gjithë qytetarët e Kosovës janë të obliguar ligjërisht që t'i përgjigjen regjistrimit dhe të japid informata të sakta për çdo anëtar të familjes. Kryetari Latifi u zotua për gatishmërinë e plotë të komunës së Rahovecit për bashkëpunim me ASK-në, në mënyrë që të sigurohen të dhëna sa më të sakta dhe të dyja palët u dakorduan për bashkërendim të planit për realizim sa më të suksesshëm të këtij projekti.

Në praninë e një numri të madh të qytetarëve, të arkitektëve, të sipërmarrësve, të grupeve të interesit, të krytarëve të këshillit të fshatrave dhe të lagjeve urbane, në sallën e Kuvendit komunal të Rahovecit, u organizua takimi për konsultim publik për PZHK-në, me ç'rast u bë prezantimi publik i hartimit të planit, i cili përcakton drejtimet e zhvillimit të komunës sonë në tetë vitet e ardhshme. Drejtori i Drejtorisë së UPMM-së, Albnor Mullabazi, theksoi se plani është punuar në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm dhe është në fazën finale të tij. Ky plan është multisectorial që ka për qëllim zhvillimin strategjik, ku pas miratimit të PZHK-së menjëherë do të vazhdojmë të punojmë rreth Hartës Zonale. Sa i përket takimeve publike, deri më tanë janë mbajtur 15 takime në zona rurale dhe urbane. Arkitektët Diellza Çanta dhe Shpejtim Mustafa, prezantuan planin përmes përshkrimit tekstual të pjesës ligjore dhe në tërësi, duke veçuar: Kornizën e Zhvillimit, Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Qëllimet e Planit të Veprimit. Në fund, qytetarët parashtruan pyetje rreth planit, të cilave drejtori Mullabazi iu përgjigj në mënyrë konkrete. Përveç këtij takimi, takimet e tjera do të vazhdojnë nëpër lokalitete të ndryshme të komunës sonë, deri në përfundim të shqyrtimit publik, sipas programit të paraparë.



Bashkë me nënkyetarin Fatmir Iska, ekipin e tij dhe menaxherët e projekteve, kryetari Latifi ka takuar operatorët ekonomikë që kanë kontrata me komunën e Rahovecit për realizimin e projekteve të ndryshme, qofshin ato infrastrukturore apo shërbime, që janë në të mirë të qytetarëve. Kërkoi nga ana e tyre t'i respektojnë kontratat dhe afatet e parapara për realizimin e projekteve si dhe kërkoi kujdes të shtuar pasi nuk ka pasur e as që do të ketë kompromis për projektet të cilat nuk kanë cilësinë e duhur.

Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, bëri homazhe në vendin ku ndodhi përbalja me pritën armike mbi fshatin Fortesë dhe në Krushën e Madhe të Fitimit, për të përkujtuar dëshmorët e kombit Skënder Rexhepi nga Mrasori dhe Fitim Duraku, natën e 21 janarit të vitit 1999, në 24-vjetorin e rënies së tyre. Prandaj, do të kujtohen dhe do të nderohen për këtë sakrificë madhore. Veprat e dëshmorëve nuk vdesin kurrë, ato jetojnë midis nesh, sepse veprimtarët dhe luftëtarët si Fitimi dhe Skenderi, u angazhuan, luftuan dhe ranë për idealin e çlirimt dhe të bashkimt kombëtar.



2023.

Hapja dhe pastrimi i përroit Bellaja drejt përfundimit.

Tani do të vazhdojnë punimet në segmentin e fundit nga magjistralja Prizren- Gjakovë deri te lumi Drini i Bardhë.

Së bashku me Drejtorin Menaxhues të Fondit të Kosovës për Efiçencë të Energjisë, z. Ahmet Ismaili dhe z. Naim Bujupi- Udhëheqës i Departamentit të Operacioneve, nënshtrukam 4 Marrëveshje për Shërbime në Efiçencë të Energjisë për 4 objekte shkollore të komunës sonë. Sipas kësaj marrëveshjeje, shkollat në të cilat do të zbatohen këto projekte janë:

- ✓ Shfmu "Rilindja", me vlerë 117,508.60 €
 - ✓ Shfmu "Gëzim Hamza-Piktori", me vlerë 154,933.36 €
 - ✓ Shfmu "Dëshmorët e Zatriqit", me vlerë 68,560.70 €
 - ✓ Shfmu "Faik Konica", me vlerë 60,840.85 €.
- Sipas marrëveshjeve, këruam nga zyrtarët e Fondit të Kosovës për Efiçencë, që realizimi i këtyre projekteve të përmbyllët deri më 31 gusht.





Komuna e Rahovecit, përfiton nga granti i performancës "Mjedisi i Pastër" në vlerë prej 156,000.00 €uro.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), mbështetur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), ka lansuar grantin e performancës "Mjedisi i Pastër". Gjatë këtij lansimi janë prezantuar përpjekjet e përbashkëta në vlerësimin e performancës komunale në fushën e menaxhimit të mbeturinave, ku komuna e Rahovecit ka përfituar: Një kamion kiper për mbledhjen e mbeturinave të llojlojshme.

Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, bënë homazhe te vendi i rënies në Brestoc si dhe në Qendrën Kulturore "Mensur Zyberaj" në Rahovec, u mbajt manifestimi përkujtimor e kulturor "FLAKA E JANARIT", në kujtim të 33- vjetorit të përfjetësimit të 4 heronjeve: Nesimi Elshani nga Nagaci, Agron Fetahu nga Celina, Halim Hoti nga Krusha e Madhe dhe Ilmi Krasniqit nga Hoça e Vogël e të plagosjes së dhjetëra liridashësve nga plumbat e forcave speciale të milicisë serbe, në Lugun e Brestocit, poashtu me pietet të lartë nderuan kujtimin për demonstratën gjithëpopullore të datës 27 janar 1990.





nën ndikim të alkoolit, 1485 raste të tiketave për parking joadekuat. Rreth sigurisë në shkolla janë 22 raste. Prej tyre ishin sulme, sulme seksuale dhe asgjësim të pasurisë.

Udhëhequr nga Kryesuesi, Defrim Kafexhiu, është mbajtur mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovcit për vitin 2023. Të pranishëm në seancë, përvèç anëtarëve të kuvendit, si zakonisht ishin edhe Kryetari i Komunës, Smajl Latifi, Nënkyetari Iska dhe drejtorët e drejtive komunale. Në fillim të seancës kishte pyetje të kuvendarëve për kryetarin e komunës, rreth infrastrukturës në sport- (stadiumi), infrastrukturës në arsim, rreth tatimit në pronë, rreth mbulueshmërisë financiare, subvencionimit në bujqësi, rekondimeve të auditorit dhe rreth raportit finansiar për vitin e kaluar. Në të gjitha pyetjet e parashtuara, anëtarët e kuvendit morën përgjigje të struktura dhe konkrete. Në rend dite ishin 20 pikë diskutimi dhe shqyrtimi, ku të gjitha pikat e rendit të ditës u votuan me shumicë votash nga anëtarët e kuvendit.

MBAHET MBLEDHJA E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI, E PARA PËR VITIN 2023
 Kryesuesi i mbledhjes, Kryetari i Komunës Smajl Latifi, theksoi se situata e përgjithshme në komunën e Rahovecit në këtë fillimvit dhe gjatë tërë vitit 2022, ka qenë stabile, e qetë dhe pa ndonjë ndryshim të theksuar nga takimi në takim gjatë mbledhjeve të KKSBB-së. Në këtë mbledhje u pasqyruan dhe u shqyrtuan të gjitha aktivitetet e KKSBB-së, u vlerësuan informatat rreth sigurisë dhe të gjitha angazhimet që na kanë shoqëruar gjatë vitit 2022. Komandanti i stacionit policor në Rahovec, z. Fazli Morina, foli rreth situatës së sigurisë në komunën tonë. Kësaj radhe nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022, me statistika si në vijim: kanë ndodhur 464 veprë penale, 113 incidente jopenale. Sa i përket sigurisë në komunikacion rrugor janë dhënë 8519 gjoba, prej tyre 362 tiketa ishin për persona që nuk kishin patent shofer, 12 tiketa





KOMITETI PËR KOMUNITETE MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT, TË PARËN PËR VITIN 2023

Në sallën e kuvendit, Komiteti për Komunitete i Komunës së Rahovecit mbajti takimin e rregullt. Ky ishte rendi i ditës: 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Shqyrtimi i Raportit të Punës për vitin 2022; 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2023; 4. Të ndryshme.

PËRUNDIM

Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit janar 2023.

Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj, që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendor, është liria e informimit.

Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit, përmes këtij buletini mujor, ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'u dhënë mundësi qytetarëve që të njojin dhe të vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gjelqojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, janar 2023